




## Numri Global i Identifikimit të Aseteve të Kthyeshme (GRAI)

Numri Global i Identifikimit të Aseteve të Kthyeshme është një nga dy çelësat GS1 të identifikimit të asetëve. Ky çelës GS1 është veçanërisht i përshtatshëm për menaxhimin e artikujve/pajisjeve apo mjeteve të ri-përdorshme të transportit. GRAI mund të përdoret për identifikimin e asetëve edhe për qëllim gjurmimi.

- Në proceset e shpërndarjes, asetet e kthyeshme përdoren nga kompanitë për të paketuar, mbrojtur dhe transportuar produktet fizike dhe ri-përdoren për dërgesa të shumefishta. Shembujt përfshijnë arkat, paletat, kutitë prej druri, fuçite e birrave etj. Asetet e kthyeshme mund të jenë në pronësi të një partneri tregtar, ose mund të merren me qira me anë të një sistemi ku kompanitë bashkëpunojnë për përdorimin e këtyre asetëve.

- GRAI mund të kodohet në një barkod ose në një etiketë EPC/RFID me anë të skanimit të së cilës, regjistrohen lëvizjet e asetëve të kthyeshme, për shembull, kur asetet transportohen ose kur kthehen bosh.

- GRAI (me numër serial) mund të përdoret gjithashtu për të menaxhuar procesin e mirëmbajtjes dhe për të regjistruar riparimet.
- Kur përdoret në mënyrë elektronike, GRAI ndihmon kompanitë për të gjurmuar lehtësisht dhe për të menaxhuar asetet e kthyeshme të vlefshme. GRAI gjithashtu, i mundëson kompanive vizibilitet me të lartë të zinxhirit të furnizimit; kur një kompani e di se cilat mallra përfshihen në një aset të caktuar të kthyeshëm, ajo mund të gjurmojë asetet dhe njëkohësisht të gjurmojë mallrat që ky aset përmban.



Shifra e Kontrollit  
Numer  
Alfanumer

Fillimi i Prefiksit GS1  
Shifra e Zgjatimit  
Numer Mbushes

<<< pozicioni i ndryshueshëm i fillimit  
>>> gjatësi e ndryshueshme  
<= me pak se ose e barabartë me